



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 65

Prishtinë, më 26.12.2012, ora 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

Munguan: Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Danush Ademi

Përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së: Agim Çeku, Ministër, Kadri Kastrati, Gjenerallejtënant, Shkelzen Syla, Sekretar i Përgjithshëm

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministrit z. Agim Çeku dhe Komandantit të FSK-së, Gjenerallejtënant Kadri Kastrati për punën dhe aktivitetin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë për vitin 2012;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Raportim i ministrit z. Agim Ceku dhe Komandantit të FSK-së, Gjenerallejtënant Kadri Kastrati për punën dhe aktivitetin e Ministrisë për Forcën e Sigurisë për vitin 2012

Kryetari i Komisionit- Ky takim është për raportimin e MFSK-së, si obligim kushtetues në çdo fund vit. Komisioni në vazhdimësi ka përcjell punën e Ministrisë, gjithashtu ka pranuar raporte sipas kërkesave të Komisionit, në bazë të cilave janë bërë rekomandime për të mbështetur punën dhe ngritje e kapaciteteve të saj. Tutje theksoi se nga ana e Komisionit është bërë amandamentimi i ligjeve dhe miratimi i tyre në Kuvend, të cilat i kanë mundësuar funksionimin e institucioneve. Për elaborimin e raportit vjetor të Ministrisë së FSK-së, fjalën ia kaloi, Ministrit, z. Agim Çeku.

Ministri i Ministrisë së FSK-së, Agim Çeku- Tha se nga ana e Ministrisë së FSK-së, viti 2012 është vlerësuar si i suksesshëm, kjo bazuar në arritjet që janë bërë. Për kornizën ligjore që ka vepruar Ministria e FSK-së, dhe FSK-ja, ka qenë e njëjta dhe nuk ka pësuar ndryshime që nga viti i kaluar, por Ministria ka punuar duke u bazuar në objektiva të qarta.

Fillimi i vitit 2012, është bazuar në pesë objektiva të qarta të cilat janë:

1. Aprovimi i kapaciteteve të plota operationale nga ana e NATO-s, dhe vazhdimi i punës në ngritjen e këtyre kapaciteteve.
2. Vazhdimi i ngritjes dhe ndërtimit të vlerave, të identitetit dhe dukshmërisë së FSK-së.
3. Fuqizimi i Bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal.
4. Bashkëpunimi dhe partneriteti me NATO-n.
5. Rishikimi i strukturës, misionit dhe detyrave të MFSK/FSK-së, në kuadër të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë.

Tutje tha se e gjithë puna e Ministrisë ka qenë në arritjen e këtyre objektivave, ndërsa viti 2012 është filluar me një buxhet prej 35,801,832€, ndërsa buxheti aktual i cili përmbyllet në këtë vit është 33.400.000€, pasi janë bërë kursime në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, gjithashtu janë tërhequr disa mjete financiare për nevojat buxhetore të disa ministrive të tjera. Prandaj konsideroi se buxheti i Ministrisë është realizuar në 95% të buxhetit të caktuar.

Nga ky buxhet, investime kapitale janë bërë 10.722.781€ dhe më këtë shumë është synuar përmirësimi i bazës materiale të FSK-së, me pajisje, është shtuar numri i armatimit dhe municioneve, radiolidhjeve taktike, sistemit të komunikimit dhe digjitalizimit të

informacioneve. Tutje njoftoi se objekti i ri i Ministrisë së FSK-së, është në fazën përfundimtare, financimi i së cilës bëhet nga Ministria e Administratës Publike, gjithashtu përmendi donacionet të cilat i janë dhënë Ministrisë, duke veçuar donacionet nga NATO-ja, siç është “ura lëvizëse”, pastaj dy autoblanda nga Turqia, një sërë pajisjesh pas mbylljes së Zyrës Civile Ndërkombëtare si dhe nga fondi i mirëbesimit i NATO-s, i cili ende është aktiv për FSK-në.

Në ngritjen e kapaciteteve të plota operacionale, theksoi se është vazhduar në pritje të aprovimit të kapaciteteve të plota operacionale nga NATO-ja, është instaluar instrumenti në bashkëpunim me KFOR-in, për rishikimin periodik të progresit në periudha tremujore brenda njësisë të FSK-së, me kriterë matëse dhe me tri vlerësime, të gjelbër, të verdhë dhe të kuqe, duke zvogëluar veprimet që kanë mbetur në të verdhë dhe në të kuqe.

Tutje tha se për këtë vit, me mbështetjen financiare, teknike, të trajnimeve të SHBA-së, posaçërisht Komanda Evropiane e NATO-s, është ngritur Njësi Rajonal e Kërkim-Shpëtimit e cila do të jetë edhe Qendër trajnuese e kërkim shpëtimit. Me qëllim të ngritjes së gatishmërisë, ngritjes së njësisë për reagim brenda dhe jashtë vendit, janë ngritur dy Kompani Model me strukturë tipike ushtarake dhe funksionimin ditor të saj.

Në këtë vit është bërë ngritja e korit të nënoficerëve, është bërë selektimi i 98 nënoficerëve, të cilët janë trajnuar në Evropë, trajnim të cilin e kanë kryer me sukses. Si rezultat i këtij aktiviteti është bërë përzgjedhja e 12 instruktorëve, të cilët vazhdojnë trajnimin për lider luftarak nën mbikëqyrjen e instruktorëve amerikan.

Gjithashtu një risi për vitin 2012 përbëjnë edhe trajnimet për Operacionet Paqeruajtëse, ku një tog prej 33 pjesëtarëve të FSK-së, ka marrë pjesë në trajnimin Operacionet për reagim ndaj krizave në Turqi, i cili i ka përgatitjet e duhura për zbarkim jashtë vendit. Ndërsa bazuar në objektivat e Ministrisë me qëllim të mbajtjes së gatishmërisë së FSK-së është realizuar ushtrimi fushor “Shqiponja 1” në nivel Brigade.

E arritur tjetër gjatë vitit 2012, ka qenë dërgimi i trupave jashtë vendit për ushtrime fushore, ku 12 pjesëtar të FSK-së kanë marr pjesë në “kampin Veror “ në Maqedoni. Në këtë proces e rëndësishme ka qenë bashkëpunimi me pjesëtarët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, ku kanë testuar komunikimin strategjik të trekëndëshit Kosovë-Shqipëri-Maqedoni dhe anasjelltas.

Nga ana e FSK-së janë realizuar operacione reale, siç janë operacionet e çminimit, kërkim-shpëtimit, zjarrëfikje. Janë realizuar 357 intervenime, ku është kërkuar nga qytetarët që të reagojnë në rastet e mjeteve të pa shpërthyer, 10 operacione kërkim shpëtimit, 36 intervenime për materie helmuese kimike, 33 intervenime për zjarrëfikje dhe 35 zhbllokime rrugësh nga bora.

Për trajnimin e personelit është vazhduar me shkollimin e tyre brenda dhe jashtë vendit, rreth 150 pjesëtarë të FSK-së vijojnë shkollimin në universitetet e Kosovës, kjo në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit që ka Ministria me këto universitete.

Ndërsa, për objektivin e dytë që ka të bëjë me ndërtimin e identitetit kombëtar, zhvillimin e standardeve dhe vlerave të FSK-së, Ministria ka hartuar rregulloren e standardizimit në FSK bazuar në standardet e NATO-s, dhe lidhur me këtë aktivitet është hartuar plani i veprimit për vitin 2012 dhe është në përfundim ai për vitin 2013. Në kuadër të këtij aktiviteti e rëndësishme ka qenë edhe bashkëpunimi civil-ushtarak në FSK, i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm për vendosjen e kontakteve dhe bashkërendimin e aktivitetëve të MFSK-së dhe FSK-së me institucioneve qendrore dhe lokale, rregullimi

dhe rrafshimi i rrugëve, dhurimi vullnetar i gjakut dhe shumë aktivitetet të tjera që u kanë ardhur në ndihmë autoriteteve civile.

Ministria ka pasur prezantim edhe në medime, si të shkruara dhe vizive, kjo ka rezultuar me botimin e gazetës mujore "Forca Jonë" dhe transmetime televizive në RTK me emrin "Forca Jonë", gjithashtu është aprovuar që dita e ushtrisë të jetë data 27 nëntor. Një aspekt i rëndësishëm është edhe çështja e çminimit ku 164.000 metër katrorë janë pastruar nga minat.

Në kuadër të objektivit të tretë, që i referohet bashkëpunimit ndërkombëtar, tha se MFSK, ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me tri vende, Gjermaninë, Kroacinë dhe Letoninë dhe është në proces të diskutimit edhe me vendet e tjera. Gjithashtu me qëllim të thellimit të bashkëpunimit janë nënshkruar planet dypalëshe për vitin 2013. Në kuadër të aktiviteteve rajonale FSK-ja ka marrë pjesë në dymbëdhjetë prej tyre, në kuadër të Kartës së Adriatikut. Një partneritet i shkëlqyer ekziston me Gardën Kombëtare të Ajovës, të cilët janë të angazhuar me seriozitetin më të madh që të mbështesin FSK-në, gjithashtu janë realizuar njëzet e dy vizita të nivelit të lartë në Kosovë, ndërsa nga ana e Ministrit dhe Gjenerallejtënant –it janë realizuar dhjetë vizita zyrtare jashtë vendit.

Pjesë e objektivit të katërt të Ministrisë ka qenë bashkëpunimi dhe partneriteti me NATO-n, dhe se në kuadër të këtij bashkëpunimi është thelluar bashkëpunimi me KFOR-in, janë mbajtur dy seminare për rrugën e Kosovës drejt NATO-s, e cila është shoqëruar me takime dhe vizita të ndryshme.

Në kuadër të objektivit të pestë, që i referohet rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, tha se ky proces ka filluar në muajin shkurt të vitit 2012, dhe janë të përfshira të gjitha institucionet e sigurisë dhe s ky proces drejtohet nga Komiteti Drejtues dhe se ky Komitet udhëhiqet nga Ministri i FSK-së. Ky proces vazhdon me dinamikën e paraparë dhe prite që në janar të 2013 të jetë i definuar konteksti strategjik i Republikës së Kosovës, objektiva kombëtare të sigurisë dhe të mbrojtjes, arkitekturën e sigurisë dhe mbrojtjes, emërtimi i të gjitha institucioneve të sigurisë, përcaktimi i misionëve dhe se për këtë gjë, në fillim të muajit shkurt 2013, ekipi nga Pentagoni do të vijë për të vazhduar këtë proces.

Gjithashtu janë përcaktuar objektivat e MFSK-së për vitin 2013 dhe që janë:

1. Të bëhet FSK-ja e vetëmjaftueshme dhe të vazhdoj të zhvillojë kapacitetet operacionale.
2. Bërja e FSK-së "Forcë për të mirë" në regjion.
3. Bërja e FSK-së forcë zbarkuese jashtë vendit.
4. Bërja e FSK-së Forcë e bazuar nga rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë(RSSS).
5. Të bërit e FSK-së një partner i perkushtuar i SHBA-së, NATO-s dhe BE-së.

Për arritjen e këtyre objektivave në raport janë përcaktuar aktivitetet që mbështesin arritjen e këtyre objektivave dhe se nga ana e Qeverisë është ndarë buxheti në shumën prej, 39,347,258.00€.

Në mbyllje të raportimit falënderoi anëtarët e Komisionit për mbështetjen e FSK-së, duke e vlerësuar këtë bashkëpunim si të nevojshëm për avancimin e FSK-së.

Gjenerallejtënant, Kadri Kastrati- Gjatë vitit 2012, FSK-ja ka treguar përkushtim dhe kjo është dëshmuar me sondazhet e fundit që FSK-ja është dal si forca më e besueshme. Tregues të tillë obligojnë që FSK-ja të vazhdoj me të njëjtin kapacitet në arritjen e objektivave të saj. Gjithashtu theksoi se vetëm njëra nga objektiva e parapara për vitin 2012 nuk është realizuar dhe që është trajnimi i rezervës aktive e cila sipas vlerësimeve është shtyrë për vitin 2013.

Sekretar i Përgjithshëm, Shkelzen Sylja- Në perspektivën e administratës së MFSK-së, njoftoi për planin e punës për vitin 2012 i cili është bërë në përputhje me objektivat e Ministrit, objektivat e Komandantit të FSK-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm. Synimi ka qenë realizimi i këtij plani dhe sipas tij është bërë planifikimi për realizimin e tij, gjithashtu synimi ka qenë dhe është implementimi i vendimeve të Qeverisë së Kosovës për MFSK-së. Në bazë modelit të integruar që bartë Ministria e FSK-së është përkrahur FSK-ja në hartimin e kërkesave dhe në përkrahje të implementimit të kërkesave sipas prioritetëve të përcaktuara nga Ministria.

Rexhep Selimi- Përgëzoi ministrin Çeku, Komandantin e FSK-së, Gjeneral Kastratin si dhe sekretarin e përgjithshëm z. Sylja, për të arriturat e deritanishme, duke u shprehur i kënaqur me punën e Ministrisë së FSK-së. Tutje shtoi se edhe pse detyrë e Komisionit është mbikëqyrja e zbatueshmërisë së ligjit, përkrahja e Komisionit për FSK-në do të vazhdoj edhe në të ardhmen. Gjithashtu e konsideroi të nevojshme përkrahjen e Qeverisë për avancimin e FSK-së, duke veçuar përkrahjen financiare për këtë institucion.

Fatmir Xhelili- Për raportin vjetor të Ministrisë së FSK-së, tha se është raport kualitativ që është tregues i punës së këtij institucioni.

Bazuar në raportin e Ministrisë, parashtrroi pyetjet si në vijim, drejtuar Ministrit, Çeku.

Për projektimet buxhetore për tri vitet e ardhshme, nuk është vërejtur në kornizën afatmesme të shpenzimeve që është bërë kërkesë për mjete financiare, që do të nevojiteshin për zhvillimin e FSK-së pas ndërrimit të misionit të saj. Bazuar në këto të dhëna, cila ka qenë arsye që nuk është bërë një planifikim i tillë, fakti se kjo çështje nuk është e hapur për publikun, koha jo e duhur apo kufizimet buxhetore?

A do të ketë donacione nga ana e shteteve që e mbështesin zhvillimin e FSK-së, apo do të vazhdohet me buxhetin që ka?

Për Planin e Reagimit Kombëtarë nga i cili del sistemi i menaxhimit të emergjencave për të cilën gjë e rëndësishme është bashkërendimi i komponentëve të sigurisë, a ka vërejtje për koordinimin e aktiviteteve mes komponentëve të sigurisë gjatë situatave emergjente?

A ka filluar hartimi i planeve specifike, siç është mbrojtja nga radioaktiviteti, që dalin nga Plani i Reagimit Kombëtar, çështje e cila i takon Ministrisë së FSK-së?

Agim Çeku- Në përgjigjeje të pyetjeve të z. Xhelili, tha se për planifikimin buxhetor, është krijuar një grup i veçantë i cili në kuadër të procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, merret me çështjen e financave, ndërsa Ministri i Financave është anëtar i Komitetit Drejtues në kuadër të programit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, në kuadër të këtij procesi në muajin shkurt të 2013, do të jetë e mundur të dihet

se cilat kapacitete i mungojnë ushtrisë, policisë, duke bërë renditjen e kapaciteteve që mungojnë.

Detyra e grupit punues është që të bëjë renditjen e prioritetëve dhe në bazë të tyre të bëhet hartimi i planit të zhvillimit të forcës dhe në bazë të këtij plani përcaktohet koha e implementimit të aktiviteteve të caktuara dhe ky plan i zhvillimit të forcës bëhet pjesë e kornizës afatmesme të buxhetit. Në buxhetin e vitit 2013, nuk janë të përfshira kapacitetet e reja, pasi buxheti është për zhvillimin e kapaciteteve aktuale dhe pas bërjes së planit të forcës, pritet që shumë partner do të mbështesin me donacione në zhvillimin e kapaciteteve.

Ndërsa, për sistemin e menaxhimit të emergjencave tha se në bazë të Planit të Reagimit Kombëtar, FSK-ja është reaguesi i dytë për tu ardhur në ndihmë autoritete civile në përballimin e situatave emergjente. Prandaj konsideroi se për këtë çështje ekziston një konfuzion se kush është autoriteti që bën koordinimin e aktiviteteve në raste të tilla dhe se në kuadër të procesit të rishikimit të sektorit të sigurisë do të merret në konsideratë kjo çështje, duke evituar përzjerjen e kompetencave.

Pas këtij procesi do të miratohet strategjia e re ku në bazë të saj do të bëhet amendamenti i disa ligjeve si dhe Plani i Reagimit Kombëtar, mangësi të cilat do të eliminohen gjatë këtij procesi. Ndërsa sa i përket pyetjes nëse janë bërë plane specifike, tha se akoma nuk është bërë një gjë e tillë pasi bazuar në mandatin ligjor aktual që ka FSK-ja, nuk e lejon një gjë të tillë.

Goran Marinković- Konsideroi se raporti i Ministrisë së FSK-së për vitin 2012 është gjithëpërfshirës dhe i realizuar, ku është pasqyruar zhvillimi i FSK-së gjatë këtij viti.

Tutje ngriti një shqetësim për çështjen e përkthimit në gjuhën serbe, ku si anëtar i Komisionit gjatë pjesëmarrjes në aktivitetin për “*Ditën e ushtrisë*” e organizuar nga FSK-ja, nuk i është siguruar përkthyes. Për çështjen në fjalë tha se ka shkruar letër drejtuar, Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Ministrit të FSK-së.

Bazuar në raportin e ministrisë, bëri pyetjen si në vijim drejtuar Ministrit, Çeku.

Cili është vizioni i FSK-së për integrimin e komunitetit serb, a do të ketë ndryshime në këtë aspekt apo do të jetë i njëjtë siç është tani?

Agim Çeku- Tha se për materialet në gjuhën serbe, përfshirë edhe raportin e vitit 2012, tha se nuk është përgatitur versioni në gjuhën serbe dhe se kjo ka qenë arsyeja që nuk është shpërndarë me kohë dhe se sa më shpejtë të jetë e mundur do të sigurohet edhe në gjuhën serbe, ndërsa për sigurimin e përkthimit në gjuhën serbe, tha se kjo gjithashtu është dashur të bëhet.

Ndërsa sa i përket integritetit të komunitetit serb, kjo çështje përbën një sfidë për Ministrinë për të cilën është angazhuar, gjithashtu theksoi se ekziston interesimi i të rinjve nga komuniteti serb për tu përfshirë në FSK. Për këtë qëllim është ngritur grupi punues për identifikimin e masave për rritjen e numrit të pjesëtarëve nga komuniteti serb në FSK. Gjithashtu veçoi shkollimin e katër kadetëve, dy serb dhe dy boshnjak në akademinë ushtarake në Shkup, dhe se shumë shpejtë në radhët e FSK-së do të jenë dy oficer të cilët do të përbëjnë zinxhirin komandues dhe se aktualisht janë gjashtëmbëdhjetë pjesëtar të komunitetit serb dhe asnjë pjesëtarë i pranuar nuk e ka lëshuar FSK-në.

Ganimete Musliu- Raportin e Ministrisë së FSK-së e vlerësoi si kualitativ si dhe falënderoi Ministrin dhe përfaqësuesit e FSK-së për bashkëpunimin me Komisionin. Tutje bëri pyetjen si në vijim, drejtuar Ministrit. Sa i është kushtuar rëndësi barazisë gjinore në kuadër të FSK-së gjatë vitit 2012 dhe cilat janë prioritetet për vitin 2013 për këtë çështje?

Agim Çeku- Tha se kësaj çështje i kushtohet rëndësi dhe për këtë qëllim janë ngritur strukturat dhe baza ligjore, duke veçuar zyrën për barazi gjinore në kuadër të Ministrisë, politikat e Ministrisë dhe se kjo çështje është prioritet i Ministrisë dhe se 8.23% të FSK-së e përbëjnë femrat, ndërsa grada me e lartë është Kolonel, për më tepër fjalën e morri z. Shkelzen Syla.

Shkelzen Syla- Për barazinë gjinore në kuadër të Ministrisë së FSK-së dhe FSK-së tha se mbi 30 % e përbëjnë gjinia femërore, tutje shtoi se në kuadër të Ministrisë është Njësia e veçantë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore dhe se është i krijuar rrjeti i zyrtarëve përgjegjës në të gjitha njësitë dhe kazermat e FSK-së, të cilët kanë takime të rregullta mujore.

Kryetari i Komisionit- Falënderoi për bashkëpunimin e vazhdueshëm duke uruar për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të Ministrisë së FSK-së, duke veçuar se në vitin e ardhshëm do të jetë fokusimi në mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjit dhe një kontroll demokratik i cili është i paraparë në Kushtetutë. Duke e përmbyllur se edhe në vazhdim Komisioni do të vazhdoj të përkrah punën e këtij institucioni.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi